



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr 06-7077 /2022

Klinë: 04.03 /2022

PROCESVERBAL

I mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës të Klinës në vitin 2022, mbajtur më 28. 01. 2022, filluar në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Është mbledhja e parë e kuvendit të komunës e mbajtur në vitin 2022, të cilën e hapi kryesuesi i Kuvendit z. Fadil Gashi duke përshëndetë të pranishmit dhe duke ju uruar vit të mbarë të gjithëve. Kryesuesi Gashi falënderoj për pjesëmarrje 27 anëtarët e kuvendit si dhe kryetarin e komunës, z. Zenun Elezaj, nënkryetaren, znj. Marqe Selaman, komandantin e policisë, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të KFOR, OSBE, Radio"Alba" dhe gjithë të pranishmit në sallë.

Kryesuesi kërkoj që formularin për plotësimin e të dhënave për adresë elektronike të cilin formular e , anëtarët e Kuvendit e kanë përpara vetës ndërsa për Rendin e Ditës, kryesuesi propozoi që pika e 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim-vendimit për rritjen e buxhetit të Komunës për vitin 2021, të hiqet për arsye se Kuvendi akoma nuk e ka themeluar Komitetin për Politikë dhe Financa-KPF. Në këtë seancë do të formohet KPF dhe në seancën e muajit shkurt mund të vihet kjo pikë e Rendi të Ditës, pasi që çdo gjë që ka të bëjë me buxhet e financa duhet të kaloj fillimisht përmes KPF-së.

Kryesuesi për Rendin e Ditës hapi debat.

z. Valmir Bacaj: Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Unë kam një kërkesë që pika e fundit: Pyetje e Përgjigje të ndryshohet pasi që kjo pikë po na merr shumë kohë dhe për arsye se është e nevojshme që përgjigjet të jenë më të sakta e për këtë drejtorëve dhe ekzekutivit i duhet kohë e duhur. Zgjidhje e kësaj propozoj që pyetjet të dërgohen paraprakisht me kohë, me shkrim dhe në seancë të marrim përgjigjet e duhura.

z. Fadil Gashi, kryesues: Propozim me vend por kësaj radhe të shkoj kështu siç është paraparë.

z. Esat Raci: Përshëndetje për të gjithë. Unë kam një kërkesë që dua të jua drejtoj ju e ju më pastaj ta bartni tek zyrtarët përgjegjës: Kërkoj që në seancën e Shkurtit ose maksimumi në seancën e muajit Mars, të gjitha projektet e realizuara nga shtatori i vitit 2021 deri në 20 dhjetor të 2021 të na sjellën si material i shkruar duke përfshirë koston e secilit projekt veç e veç si dhe anëtarët e pranimit të atyre projekteve, pasi që unë e kam thënë edhe në fushatë zgjedhore e po e them edhe tani, dyshoj se ato projekte kanë qenë projekte të realizuara për qëllime elektorale.

z. Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit Esat. Edhe unë kam një kërkesë të vogël. Gjithë këtë që e the a mund ta bëni në formë kërkesë me shkrim, kërkesë zyrtare dhe ta përcillni në ekzekutiv. Besoj që edhe ekzekutivi do të përgjigjet.

Kryesuesi e vuri ne miratim Rendir e Ditës me [propozimin e tij për heqjen nga Rendi i Ditës së [pikës së 5 dhe me 27 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA.

Pika e 1-Arshyrtimi i mungesave

U konstatua se [prezent në mbledhje janë të gjithë anëtarët e kuvendit

Pika 2 – Dhënia e betimit të dy anëtarëve të rinjë të cilët zëvendësojnë dy anëtarët që kanë dhënë dorëheqje,

Znj. Shukrije Shala jep betimin

z. Kolë Prenaj jep betimin

Pika 3 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Asnjë nga anëtarët e kuvendit nuk kishte vërejtje rreth procesverbalit prandaj u MIRATUA me 27 vota për.

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për caktimin e shefave të grupeve kuvendare.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje të gjithëve. Për shef të gr. Kuvendar të AAK e propozojmë z. Valmir Bacaj.

z. Esat Raci: Grupi ynë kuvendar është dakorduar që për shef grupeve dhe të tjera ka vendosur që ta bëjë me rrotacion. Kjo është çështje e brendshme e grupit tonë por për hirë të transparencës po e bëjë publike. Kësaj radhe shef grupi propozohet Esat Raci.

z. Enver Gashi: Përshëndetje për të gjithë. Grupi ynë i LDK-së propozon z. Arben Limanaj.

Znj.Valmira Krasniqi: Grupi ynë i LVV propozon z. Zafer Gashi për shef të grupit kuvendar.

Kryesuesi i Kuvendit z. Gashi i uroj të gjithë shefat e grupeve kuvendare me shpresën e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe kaloj në pikën e radhës së Rendit të Ditës.

Pika 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së ekzekutivit për vitin 2022.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Përshëndetje për të gjithë. Në këtë fillim mandat të qeverisjes menjëherë kemi filluar me përgatitjen e planit të punës sipas përgjegjësive të të gjitha drejtorive dhe aktet e funksionimit të pushtetit lokal. Duke u bazuar gjithashtu në të gjitha dokumentet politike të aprovuara nga Kuvendi i Komunës, siç është strategjia zhvillimore dhe të tjera. Është përgatit një plan i punës i cili do të jetë në të mirë të qytetarëve të Komunës së Klinës. Ne jemi të gatshëm për të gjitha këshillat dhe sugjerimet e anëtarëve të Kuvendit.

z. Zafer Gashi: Përshëndetje për të gjithë. Dua të i përshëndes të gjithë drejtorët e rijnë dhe në pika të shkurtra do të mundohem të jap opinionin tim në lidhje me këtë plan të punës sipas drejtorive duke ju uruar shumë suksese.

Drejtoria e financave, të uroj shëndet z. Aziz Desku, drejtor. Regjistrimi i pasurisë Komunale, ju keni shkruar aty se planifikimi i regjistrimit të tërë pasurisë komunale sipas udhëzimit administrativ dhe rregulloreve të tjera financiare në fuqi do të kryhet. Ne na intereson a do të planifikoni apo do ta kryeni këtë regjistrim të pasurisë komunale dhe cilat janë afatet kohore.

DKRS, përshëndetje të veçantë për drejtoreshën. Po e lexoj që i keni radhitur shumë mirë të gjitha aktivitetet që planifikoni të i realizoni, vetëm do të doja të jeni pak më preciz në subvencionet që do të i jepni klubeve. Ndoshta keni harruar se përveç këtyre që i keni përmendur ka edhe klube të tjera sportive si p.sh. Klubi i boksit dhe klube të tjera të regjistruara në federata e që nuk janë në listën tuaj të planifikuar për subvencione.

Drejtoria e Shëndetësisë. Përshëndetje të veçantë gjithashtu për drejtorin e ri. Jam i vetëdijshëm për sfidat që i ka kjo drejtori. Do të doja të pyes, a ka ndonjë buxhet që do të përdoret për menaxhimin e pandemisë sepse sa pashë unë pjesa kryesore e buxhetit është planifikuar për aspekte teknike si ndarja e ordinancave etj. Pra çka përfiton qytetari nga shërbimet e këtij institucioni në këtë kohë pandemie. A është ndarë ndonjë buxhet në rast të nevojave rreth pandemisë.

Drejtoria e urbanizimit, e përshëndes drejtorin shumë. E diji që ka me pas shumë sfida sepse nuk i ke pas punët mirë të trasuara edhe nga e kaluara, drejtor. E shoh në planifikim se keni evidentuar si të bartura punët rreth stacionit të autobusëve. Unë e diji që në fushatë kryetari ka thënë se vetëm fushata po e pengon se stacioni është i gatshëm për me e pre shiritin e përurimit sepse është e kryer. Gjithashtu nuk e shoh askund planifikimin për ndërtimin e trotuarit në Sferkë. Aty janë ndërtuar vetëm afërsisht 100 metra dhe është ndërprerë. Nëse mundet me na dhënë ndonjë sqarim ku është pengesa për vazhdimin e atij trotuari.

Drejtoria e bujqësisë. Mendoj që është një gabim kur keni shkruar se drejtoria e bujqësisë gjatë vitit 2021 planifikon. Me siguri e keni bërë copy-past. Viti 2021 nuk ka qenë shumë i mirë për juve. Besoj që duhet ta përmirësoni e ta shkruani për vitin 2022. Nuk e kam të kuptueshme tek investimet që shkruani për penda, a mos është projekt i drejtorisë së urbanizimit dhe gabimisht është futur në drejtorinë tuaj.

Këto do të ishin në pika të shkurtra që për mua e mbase edhe për anëtarët e kuvendit duhet sqarim. Ju kërkoj falje për kohën e marrë.

Kryesuesi tha se disa nga projektet që nuk i shihni në këtë plan janë projekte që kanë nisur në vitin e kaluar dhe ato gjithsesi që do të vazhdojnë të kryhen. Po ashtu kryesuesi, Gashi ju ofroj që të marrin fjalën nëse ka edhe dikush tjetër nga anëtarët e kuvendit para se ekzekutivi të jep përgjigjen në disa çështje që u ngritën.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Po mundohem në mënyrë përmbledhëse të përgjigjem. Mendoj që të gjitha të gjeturat që i përmendi, Zafer Gashi edhe drejtorët do ti marrin parasysh dhe do të i përmirësojnë nëse është e nevojshme. Tek regjistrimi i pasurisë është obligim i komisionit komunal që të bëjë regjistrimin e pasurisë kur janë afatet ligjore dhe të përfundoj e jetë gati pasqyra e pasurisë komunale sipas afatit. Sa i përket subvencioneve të klubeve sportive, të gjitha klubet dhe OJQ e kanë të drejtën që të aplikojnë në program kur të bëhet shpallja, natyrisht paraprakisht të dorëzojnë raportin financiar nëse kanë qenë përfitues të më hershëm të subvencioneve. Buxhetin për pandeminë. Ne kemi pasur procedura prokurimi për pandeminë. Kryesisht kemi nda buxhet në vitin 2020 por jo në vitet e tjera pasi që është bërë furnizimi i rregullt për rastet e covidit. Nëse vije nevoja që të ndahet fond shtesë ne do të i drejtohem kuvendit. Sa i përket trotuarit në Sferkë, do të vazhdon ndërtimi i trotuarit në këtë vit. Programi ynë është që të përfundon në tërësi në vitin e ardhshëm. Sa i përket stacionit të autobusëve ne kemi probleme tjera e që është themelimi i kompanisë publike që menaxhon me stacionin, kjo është arsye pse akoma nuk është vënë në shërbim. Ndoshta deri të formohet kjo kompani publike, ne do të i lejojmë autobusët që të parkohen dhe ndalojnë në këto hapësira. Investimet në këtë stacion do të vazhdoj edhe më tutje e që këtë vit është faza e mbulesës së peronave. Nuk kemi mundur që të i përfshijmë ne termat e referencës vitin e kaluar shkaku i rritjes së madhe të çmimeve të llamarinës me të cilën do të mbulohen peronat. Do ta përfshijmë këtë vit por gjithsesi këtë vit e kemi prioritet të bëjmë themelimin e kompanisë publike.

z. Fadil Gashi, kryesues: Unë ju kisha propozuar që planin e fundit ta shikoni se a është realizuar në fund e jo të shpenzoni energji tani.

Kryesuesi e vendosi në votim dhe me 20 votë për, 7 abstenime dhe asnjë kundër u MIRATUA.

Pika 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i planit të punës së Kuvendit

Kryesuesi theksoi se anëtarët e kuvendit e kanë marrë me kohë edhe planin e punës së kuvendit por edhe kalendarin dhe ky planë e ky kalendar mund të ketë plotësime gjatë

vitit. Gjithashtu edhe në kalendar theksoi se janë të evidentuara datat e planifikuara për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit dhe të komiteteve. Disa komitete nuk janë themeluar akoma prandaj ka mbetur hapësira për ato komitete. Para se të vejë në votim jua dha fjalën të pranishmëve por pasi që asnjë nuk e morri fjalën, kryesuesi e vuri në votim dhe me 27 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim **U MIRATUA.**

Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2021-2022

z. Qemajl Sejdiqja, drejtor i DKA: Përshëndetje të gjithëve. Duke u bazuar në rregulloren për ndarjen e bursave, me lejoni që para juve të paraqes propozim vendimin për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2021-2022. Gjithsejtë janë 40 bursa të planifikuara për ndarje, në vlerë prej 50 euro. Ju faleminderit.

Znj. Valmire Krasniqi : Ne si grup kuvendar i LVV kërkojmë që numri i bursave për studentë të rritet për 60 si dhe kemi një kërkesë tjetër që për shkak të kushteve ekonomike të krijuara nga pandemia të shtohen edhe 50 nxënës të shkollës së mesme, të paktën të ju financohet udhëtimi.

z. Qemajl Sejdiqja, drejtor i DKA: Ne do të i shohim mundësitë dhe do të i shqyrtojmë mirë kërkesat.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Sipas planifikimeve buxhetore për këtë vit janë 30 bursa por ne i kemi rritur për 10. Për nxënës duhet të jetë një vendim i ri i kuvendit. Si propozim mendoj që duhet ta arsyetojmë mirë dhe bashkërisht të marrim një vendim, mjete ka nga kategoria e subvencioneve për nxënës. Mund ta realizojmë, drejtorja merr informacionet e nevojshme.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje për kryetarin e Komunës, nënkryetaren dhe gjithë të pranishmit. Propozimi im do të ishte që të shtohen akoma më shumë bursa për studentë, të rritet në 100 sish por vetëm të shikohet mirë mundësia buxhetore. Sa i përket bartjes së nxënësve me autobus, të bëhet kjo për të gjithë nxënësit gjithmonë duke u bazuar në rregulloren që është për këtë punë.

Esat Raci: Çdo anëtar i Kuvendit ka vullnet që të rritet numri i bursave por varet krejt nga mundësitë buxhetore.

Kryesuesi sqaroi çelësin e përbërjes së komisionit për ndarjen e bursave.

z. Zafer Gashi: Propozoj që dy anëtarë nga kuvendi me mirëkuptim të jenë nga opozita.

z. Fadil Gashi, kryesues: Çdo ndryshim i çelësit do të thotë që duhet ndryshuar rregullorja. Ne nuk mund ta ndryshojmë rregulloren.

z. Valmir Bacaj: Nga praktikat e kaluara, kemi pasur një propozim Pozita dhe një Opozita. Ne e kemi propozimin e gatshëm, Janë kriteret që përcaktojnë se kush përfiton bursë dhe nuk do të i bëhet askujt e padrejtë, të hiqet kjo dilemë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ne kemi ndryshuar rregulloren për shkak të defekteve që janë vërejtur, tani komisioni e ka më lehtë sepse janë kriteret e përcaktuara.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje të gjithëve. Nuk e diji a kaluam tek pika e propozimit të anëtarëve të komisionit apo jemi akoma të propozim vendimi.

Kryesuesi Gashi, propozim vendimin e DKA e vuri në votim dhe me 27 vota Për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Arben Limanaj: Ne si grup propozojmë që dy anëtarët e Kuvendit të jenë nga opozita dhe të jenë të profesionit të cilët e njohin rregulloren për ndarjen e bursave. Në të kaluarën kemi pasur vonesa duke na zënë viti tjetër akademik. Ne si grup kemi një propozim i cili ka qenë drejtor i arsimit, **z. Enver Gashi.**

z. Valmir Bacaj: Në fakt ne i kemi përgjegjësitë e ndara si legjislativ dhe ekzekutiv. Propozimi i grupit të AAK është **Arlinda Selitaj.**

z. Fadil Gashi, kryesues: Po e sqarojmë që në fillim. S` ka me pas hile në këto ndarje sepse është edhe komisioni për shqyrtimin e ankesave. Do të vije prap këtu në kuvend. Asgjë nuk shkelet as rregullorja edhe nëse krejt anëtarët e komisionit janë nga opozita ose nga pozita. Nuk ka me pas asnjë keqpërdorim sepse janë rregulloret e qarta.

z. Esat Raci: Dëshiroj që të i bashkëngjitëm propozimit të Zafit dhe Arbenit që anëtarët e komisionit nga Kuvendi të jenë nga Opozita. Konkretisht ne si grup kuvendar propozojmë **z. Kushtrim Halitaj.**

z. Zafer Gashi: u tha që në fillim nga ju se është rregullorja dhe nuk mund ta ndryshojmë. Unë kërkova kompromis dhe mirëkuptim nga pozita që dy anëtarët e kuvendit të jenë nga opozita, Propozimi ynë është që anëtar të jetë **Mirjetë Gashi** e cila është juriste.

z. Valmir Bacaj: Nuk po më pëlqen tendenca e opozitës të i ketë vetëm anëtarët e vet. Ne tërhiqem nga propozimi ynë, le të i marrin opozita dhe uroj që ta respektojnë rregulloren.

z. Esat Raci: Pasi që jemi grupi më i madh opozitar ne si gr. i PDK-së, tërhiqemi nga propozimi ynë.

Nga kuvendi mbetën të propozuar: z. Enver Gashi dhe Mirejtë Gashi si dhe emrat që do të i dërgoj ekzekutivi dhe shoqëria civile. Kryesuesi e vuri në votim dhe me 27 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 9 e Rendit të Ditës: Raporti vjetor i Policisë së Kosovës – stacioni policor në Klinë

z. Ragip Bytyqi, komandant i St. Policor në Klinë: I nderuari kryetar, kryesues, nënkryetare, drejtorë, asamblistë, qytetarë të Klinës, ju përshëndes të gjithëve. Pas bisedës që kemi zhvilluar me kryetarin dhe kryesuesin jemi pajtuar që raportin e punës të jua dorëzojmë këtu. Besoj që edhe në të ardhmen duhet të vazhdojë kështu. Ju jeni

ata që duhet të i merrni informacionet e para. Stacioni policor në Klinë në vitin 2021 i ka përcaktuar disa objektiva të cilat objektiva i ka realizuar në përpikëri. Si objektiva kryesore kanë qenë: Parandalimi i veprave penale, arrestimi i kryerësve të këtyre veprave, rritja e zbulueshmërisë dhe luftimi i përhapjes së pandemisë covid19. Në vitin kalendarik 2021 janë paraqitur gjithsejtë 567 raste, ku nga këto raste 376 raste janë të veprave penale ndërsa 191 raste janë vepra që nuk kategorizohen në bazë të kodit penal si vepra penale. Në vitin 2021 fatkeqësisht kemi pasur një vrasje, ku autori është arrestuar dhe është në procedurë gjyqimor. Kemi pasur një rast tentim vrasje, 30 kanosje, 14 sulme të natyrave të ndryshme dhe 41 lëndime të lehta trupore ndërsa 5 raste të lëndimeve të rënda trupore. Në vitin 2021 tek veprat penale kundër familjes kanë pësuar rritje . Gjithsejtë janë 40 raste të dhunës në familje, 11 raste narkotik, 7 vepra penale kundër ekonomisë kryesisht falsifikime të monedhave. Shqetësuese kanë qenë veprat penale kundër pasurisë. 42 vjedhje janë raportuar në vitin 2021. Për dallim nga viti 2020 kemi pasur rënie për 30% e që ky ka qenë edhe objektivi i policisë së stacionit në Klinë në parandalimin e këtyre vjedhjeve. Kemi pasur 7 tentim vjedhje dhe 47 vjedhje të rënda dhe 5 vjedhje të shërbimeve. Kjo e fundit ka qenë risi në komunën tonë. Për gjitha këto vjedhje janë zbuluar dhe arrestuar kryerësit. Kanë qenë 3 grabitje. Prej këtyre 3 grabitjeve, dy janë zgjedhur dhe një rast është akoma në fazën e hetimeve. Kemi gjithashtu 20 dëmtime të pasurisë dhe 8 raste të mashtrimeve. Janë konfiskuar 24 armë të ndryshme, janë dy raste të përdorimit të armës dhe 262 copë municion të kalibrave të ndryshëm të konfiskuara. Kanë qenë tre pengime në kryerjen e detyrës së personit zyrtar dhe dy sulme të personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare. Shkaktim të rrezikut të përgjithshëm kanë qenë 7 raste, një rast i ndërtimit pa leje dhe një rast punim ndërtimor i pa ligjshëm. Në zonën tonë të përgjegjësisë, tek aksidentet, kemi pasur fatkeqësisht 3 aksidente me fatalitet me 4 persona të vdekur, 34 aksidente me lëndime të lehta trupore, 160 aksidente me dëme materiale. Janë shqiptuar 9993 gjoba, që krahasuar me vitin 2020 ka pasur rritje mbi 60%. Në bazë të dokumentacionit që e kemi pranuar deri me tani janë inkasuar mjete në vlerë prej 276 mijë e 796 euro. Zbulueshmëria e vetëm veprave penale këtë vit ka arritur në 87.7%. Duke i përfshirë edhe incidentet e tjera që nuk janë vepra penale, zbulueshmërinë e rrisin në 91.7%. Shifër kjo që në zhargonin tonë policor është për tu kënaqur. Shofer që tregojnë një aktivitet të shtuar të të gjithë zyrtarëve policor pa përjashtuar edhe ndihmën e qytetarëve. Përveç këtyre veprave penale , ne si stacion policor kemi pasur edhe disa aktivitete operative. Janë realizuar gjithsejtë 51 plane të ndryshme operative, dy protesta, 104 raste asistimesh në gjykatë, janë realizuar 3906 pika kontrolli, 676 patrullime këmbë, 2135 patrullime me veturë, janë lëshuar 1048 dokumente për humbje të dokumentacionit. Janë lëshuar 2803 certifikata për verifikimin e të kaluarës kriminale. Janë realizuar 90 kërkesa për armë të gjuetisë, janë bërë 428 kërkesa për armë të shenjterisë, janë pranuar nga ana e gjykatës dhe prokurorisë 250 urdhëresa ku të gjitha janë realizuar. Gjithsejtë janë arrestuar 483 persona. Janë realizuar dy takime me KLSP me Drenoc dhe Dresnik dhe dy takime me KKSB.

Raportin e punës së stacionit policor në Klinë duhet me orë të tëra me e shtjelluar por unë kam zgjedhur që në pika të shkurtra të ju raportoj me qellim që mos të ju marr

kohën tuaj. Shfrytëzoj rastin që të i falënderoj secilin qytetar si dhe asamblistët e mandatit të kaluar të cilët kanë kontribuar në këtë rezultat.

Kryesuesi i Kuvendit, z, Fadil Gashi e falënderoj komandantin Bytyqi për raportin e dhënë dhe i premtoj që edhe si institucione edhe si qytetarë do të vazhdoj bashkëpunimin e ngushtë.

Pika e 10 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të prokurimit për vitin 2022.

z. Abaz Foniqi, zyrtar i prokurimit: Përshëndetje për të pranishmit. Unë në cilësinë e zyrtarit këshillues pasi që zyrtari i prokurimit nuk gjendet , është me arsye, mund të ju informoj për planifikimin e prokurimit për vitin 2022. E dini se ky planifikim është bërë bazuar në buxhetin e miratuar për vitin 2022 dhe njërive kërkuese. Në planifikim e prokurimit për vitin 2022 është kriter ligjor që duhet të bëhet. Ju keni marrë një tabelar të përgatitur nga zyra e prokurimit por që është unik nga sistemi i e-prokurimit i cili nuk i ndanë në departamente por i ndanë me kategori. Ne materialin që keni marrë na dalin 119 procedura prokurimi që në një vlerë monetare të planifikuar 4 milion e 167 mijë e 267 euro. Ose ndarë në grupi, në lloje të procedurave janë: Për furnizime me mallra- 22 procedura, për shërbime-30 procedura, për projekte kapitale-45 procedura dhe janë paraparë edhe dy procedura për konkurse projektimi. Mund të ju them se në këtë plan prokurimi nuk janë shumë projekte që janë të kontraktuara dhe kanë validitet më shumë se një vit. Procedurat që ekziston kontrata e filluar në vitin 2021 vazhdon edhe në 2022 e tutje por që në planin e prokurimit nuk futen. Pastaj për mallra dhe shërbime kemi një mori kontrata kornizë që kanë validitet më tepër se 12 muaj , d.m.th. ende janë aktive, edhe këto nuk janë të futura në këtë plan të prokurimit. Ka vend për përmirësim por plani i prokurimit nuk është i mbyllur. Ligji i prokurimit e ka lejuar që sipas kërkesave të njërive kërkuese mund të futen projekte të reja gjithmonë duke bërë kërkesë në AQF për nevojën e procedure. Ju falënderoj shumë, nëse keni ndonjë pyetje do të mundohem që të përgjigjem.

z. Zafer Gashi: E falënderoj z. Foniqi. E kuptova që paska projekte që kanë afat vazhdimi nga vitet e kaluara dhe nuk janë futur në këtë plan prandaj po rezervohem nga shumë pyetje që kisha. Ju thatë se ka projekte që do të vazhdojnë edhe për dy vjet, a do të jeni ju në zyre që të i përcillni këto projekte pasi që ju keni dalur në pension. A mund të na sqaroni se si po e kryeni punën tani? A jeni me kontratë apo si? Vetëm sa për sqarim të pozicionit tuaj. Zyrtari tjetër i prokurimit a ka filluar punën akoma?

z. Abaz Foniqi, zyra e prokurimit: Është e njohur tashmë publikisht se në zyrën e prokurimit nuk ka menaxher të përhershëm. Është një konkurs i hapur që është në përfundim. Për momentin është i emëruar një zyrtar i prokurimit me titullin Menaxher i prokurimit, i cili punon në drejtorinë e Urbanizimit por që i ka kompetencat që ta përcjell punën e zyrës së prokurimit. Ndërsa unë jam i angazhuar me një kontratë në cilësinë e ekspertit të prokurimit publik. Është kontratë një vjeçare dhe quhet shërbim i veçantë. Do ta përcjell punën nga viti i kaluar tek zyrtarët e rinjë që do të vijnë.

Kryesuesi i kuvendit, z. Gashi duke i uruar shëndet z, Foniqi e falënderoj për raportin dhe ftoj anëtarët e kuvendit që ta votojnë këtë planifikim prokurimi.

Me 27 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 11 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për themelimin e komisionit për emërtimin e rrugëve.

Kryesuesi theksoi se kuvendi a pasur një komision për këtë qellim por ka skaduar mandati i Komisionin. Është ndryshuar rregullorja e kuvendit e cila ka përcaktuar kriteret dhe tani theksoi ai se ka një propozim për anëtarët e Kuvendit. " Kuvend i ka pasur katër anëtarë për këtë Komision ndërsa pesë anëtarë jashtë Kuvendi. Jashtë Kuvendit komisioni duhet të ketë këta përfaqësues: një përfaqësues nga Komuniteti jo shumicë, një nga shoqëria civile, një historian, një gjeograf dhe një përfaqësues për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nga kultura. Këta anëtarë jashtë kuvendi përmendur me emra janë: Gazmend Dauti, Alban Gashi, Gjyle Halilaj, Ali Raci, Shani Toqani. Nëse jeni të pajtimit këta anëtarë mund të vazhdojnë të jenë akoma anëtarë të kuvendit duke i propozuar edhe 4 anëtarë të rijne nga kuvendi"-theksoi kryesuesi Gashi, duke pyetur edhe një herë anëtarët e Kuvendit që të deklarohen nëse janë dakord me këtë propozim.

z. Tunë Dedaj: Unë pajtohem plotësisht që të vazhdohet me anëtarët që i përmende sepse për kontinuitet duhet të jenë. Gjithashtu kërkoj që grupet kuvendare në kuvend të propozojnë njerëz që janë punëtorë, aktiv dhe që e kryejnë punën me nder në mënyrë që mos të mbesim mbrapa sikurse kemi mbetur në të kaluarën.

z. Fadil Gashi, kryesuesi: Mirë që e kujtove ti sepse unë nuk e thash. Në mandatin e kaluar jemi vonuar dhe na është dashur që ta ndërrojmë komisionin shkak i mos punës.

z. Valmir Bacaj: Besoj që komisioni që tani do ta zgjedhim do të jetë më i përgjegjshëm se sa i mandatit të kaluar. Ne si gr. i AAK e propozojmë për anëtar të këtij komisioni znj. Ilirjana Toplanaj.

Kryesuesi mes të tjerash theksoi se ky komision duhet të paguhet gjithsesi për punën që e bënë. Këtu është edhe drejtori i financave, z. Aziz Desku i cili po e përcjell këtë seancë. Pra duhet të jemi të qartë se ky komision për punën që do ta bëjë, do të paguhet në bazë të rregullores.

z. Esat Raci: Edhe ne dakordohemi me propozimin tuaj ndërsa nga grupi ynë propozojmë z. Kushtrim Haliti për anëtar të Komisionit.

z. Arben Limanaj: Grupi ynë propozon znj. Marigona Racaj. Unë kam qenë vet anëtar i komisionit dikur dhe asnjë herë nuk janë paguar prandaj kërkoj që në seancat e radhës të silltet një vendim për kompensimin e punës së këtij komisioni. Kompensimi është primar për me pas efikasitet në punë.

Z. Zafer Gashi: Ne i përkrahim të gjithë anëtarët e përmendur më herët që kanë qenë. Besojmë në seriozitetin e këtij komisioni. Grupi ynë i LVV propozon znj. Lirije Gashi për anëtare të këtij komisioni.

Këto propozime, kryesuesi i kuvendit i vuri në votim dhe me 27 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 12 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave në Komunën e Klinës.

Edhe për këtë çështje kryesuesi i kuvendit, z. Gashi theksoi se duhet të zbatohet rregullorja dhe celsi i përcaktuar në bazë të kësaj rregullative. 1 anëtar nga Ekzekutivi, 4 nga Kuvendi, 1 nga shoqëria civile dhe 1 përfaqësues që vjen me automatizëm nga fshati ku bëhen zgjedhjet.

U propozuan: Luigj Ademi, Arta Pantina, Nrec Zefaj, Zafer Gashi, nga ekzekutivi për plotësim dhe shoqëria civile.

Këto propozime u vunë në votim dhe me 27 vota PËR u MIRATUA.

Pika 13 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për themelimin e Komiteteve obligative: Komitetit për financa dhe komitetit për komunitete.

Për Komitetin për Financa-KPF, u propozuan: 1. Tunë Dedaj, 2. Blerta Gashi, 3. Mendehe Duraku, 4. Bledar Berisha, 5. Blerina Gashi, 6. Valmire Krasniqi.

Propozimet u vunë në votim dhe me 27 vota për u MIRATUA.

Për komitetin për komunitete, celsi është 4 anëtarë të komuniteteve dhe 3 nga Kuvendi. U propozuan: 1. Vehbi Alaj, 2. Marigona Kerellaj, 3. Nexhmedin Gashi, 4. Tanja Kostic, 5. Shukrije Shala, 6. Besiana Gashi, 7. Arben Limanaj.

Propozimet u vunë në votim dhe me 27 vota për u MIRATUA.

Pika 14 e Rendit të Ditës: Interpelanca me kryetarin e Komunës rreth gjendjes në arsim.

Kryesuesi theksoi se për këtë interpelancë ka pasur një kërkesë nga LVV të cilët ju kanë referuar një teme të caktuar. Ai i luti që të i përmbahen temës dhe minutazhes së përcaktuar në bazë të rregullores për interpelancë.

z. Zafer Gashi: Ju falënderoj për vendosjen në rend të ditës të kësaj pike. Ne mendojmë se është shqetësuese ajo që ka ndodhe në arsim. Ne kërkojmë që të debatohet për vendimin e fundit që e ka dhënë inspektorati i arsimit. Ku taklaktivisht thirret në udhëzime administrative dhe theksohen ligjet në fuqi. Inspektorati i arsimit, personelin që ka dhënë mësim në atë shkollë e konsideron të pa kualifikuar. Shqetësimi ynë është gjendja e tanishme, që sipas informacioneve që kemi tash është hap një konkurs që nuk është në rregull. Si erdhi deri tek kjo. – DKA ka shpallur një konkurs

publik me datë 03. 08. 2021 për pozitën e lirë: Infermier- master në infermieri, në shkollën e mesme profesionale "Fehmi Agani". E që Master në infermieri në Kosovë nuk ka. Testi me shkrim është mbajtur me datë 20.09.2021, shpallja e rezultateve të testit me shkrim është bërë me 01.10.2021. Ankesat janë dorëzuar me datë 04.10.2021. Shikimi i testit kërkuar nga kandidati i ankuar, magjistër Bekim Gashi ka ndodhur me datë 07. 10. 2021. Këtu futet në lojë zonja Marqe Selmanaj, tani nënkryetare e Komunës, e cila sipas mendimit tonë nuk e ka kryer punën si duhet. Për këtë mos kryerje të punës, për shpifje dhe fyerje ndaj personit të caktuar e informoi se ka të ngritur një padi në gjykatën themelore në Pejë-dega në Klinë. Në kontrollim të testin nga z. Bekim Gashi, zonja Selmanaj thotë se personi në fjalë ja ka vjedhur "çelësin". Kjo do të sqarohet në gjykatë. Tutje, testi me gojë është i datës 11.10.2021 dhe shpallja e rezultateve me datë 14.10.2021. Nuk është pranuar personi përgjegjës sepse ka udhëzime administrative ku thuhet se: Profili mësimor për me dhënë lenden sipas konkursit duhet të jetë farmacist i diplomuar ose mjek. Aty është pranuar një zonjë me bachelor të infermierisë. Ajo që na shqetëson edhe më shumë, është tentuar dhe ka pasur oferta që të i ndajnë orët mësimore mes zonjës dhe z. Bekim Gashi. Ne kemi bërë ankesë dhe ankesa jonë është dorëzuar në komisionin për shqyrtim të ankesave me datë 19.10.2021 dhe si zakonisht ngado që të shkosh është AAK, edhe këtu ka dalur Driton Berisha me ekipin i cili ka thënë se çdo gjë është OK në këtë konkurs dhe përzgjedhje. Pas kësaj, z. Bekim Gashi ka shkuar në inspektorat të arsimit dhe është ankuar ndërsa inspektorati i arsimit ka vendosur (nxjerr vendimin e inspektoratit të arsimit dhe lutë shërbimin për shpërndarje të dokumentit por dokumenti mbetet pa u shpërndarë, pasi që kryesuesi thotë se është i shpërndarë dhe anëtarët e kanë vendimin në fjalë), nuk dua të përmend emrat e personave të cituar në vendimin e inspektoratit por aty thuhet se ata janë të pa kualifikuar sipas nenit 13 të udhëzimit administrativ 05/2011 që të japin mësim në shkollën "Fehmi Agani" në profilin e mjekësisë. Në vendim citohen emrat e personave të pa kualifikuar. Akoma më keq, mësimdhënësja që është pranuar, E.B. me kualifikim bachelor infermieri. Inspektorati thotë: Në librin e klasës së shkollës së mesme në faqen 6 tek rubrika e kualifikimeve ka paraqitur thirrjen Master e infermierisë, e edhe më keq edhe në kontratë komuna ja ka shkruar- Master e infermierisë që është një falsifikim i dokumentit zyrtar. Pas shqyrtimit të dokumentacionit siç thotë inspektorati, u konstatua si në vijim: Mësimdhënësit të cilët i jep me emra e që unë nuk dëshiroj që të i përmend këtu, janë të pa kualifikuar sipas nenit, cek nenin dhe punojnë në kundërshtim me nenin, prap cekë nenin inspektorati.

Këta persona kanë dhënë mësim dy vite radhazi. A mendoni që është bërë mirë dhe a mendoni që është mirë që teknikët e infermierisë të japin mësim në shkollën e mesme të mjekësisë. E diji që do të thirreni në nene e udhëzime por jo nuk mund të thirreni në udhëzimin a07/2017 i cili thotë se në mungesë të kandidatit të kualifikuar master dhe nivelit 4-vjekar, mund të pranohet kandidati bachelor përkatës. Jo, sepse ka pasur kandidat me përgatitje master. Keni manipuluar testin, do të shihen provat në gjykatë.

E lus kryetarin e komunës të na tregoj se si do ta zgjidhë këtë problem që këtyre nxënësve, në shkollën e mesme të mjekësisë "Fehmi Agani" të mos i humbet viti

shkollor. Së fundmi keni hapur konkurs për tre mësimdhënës për lëndën e mjekësisë. Cilat lëndë? 6-të duhet që të i punësoni dhe jo 3 mësimdhënës. Ju lutem kryetar, ju jeni i fushës së arsimit, a ndjeni ndonjë përgjegjësi pasi që këtë punë keni pasur dijeni që dy vite. E kanë ditur edhe ish drejtorët e arsimit në qeverisjen tuaj, por e keni toleruar. Unë jam në gjendje të faktoj me dokumente pik për pikë të gjeturat e konstatuara nga institucioni i inspektoratit të arsimit. Ju falënderoj.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Faleminderit. Interpelanca është thirru me kryetarin e Komunës për gjendjen në arsim dhe unë jam munduar që të përgatis përgjigjen, kryesisht për vendimin e inspektoratit. Do të përfshijë në diskutimin tim edhe shqetësimet e z. Gashi aq sa kam mundësi.

Duke pasur të nevojshme hapjen e paraleles së Infermierisë në shkollën e mesme profesionale "Fehmi Agani" në Klinë, DKA në Klinë me kërkesën e drejtuar në MASHT në vitin 2019, e që të njëjtën kërkesë sekretari i kësaj ministrie me vendimin 2-3464 të datës 16.09. 2019 e ka lejuar hapjen e kësaj paralele. Në këtë kuptim, DKA duke pasur si qëllim parësor aftësimin e nxënësve, ka angazhuar kuadër profesional të cilët punojnë edhe në QKMF, të cilët kanë të përfunduar shkollimin e duhur. Angazhimi i stafit të QKMF-së është realizuar mbi bazën e memorandumit të mirëkuptimit në mes të dy drejtorive, duke e pasur parasysh faktin se ka pasur mungesë të mjekëve dhe nuk ka pasur interesim të mjekëve për të u kyçur në procesin mësimor në shkollën e mesme. Inspektorati me datën 21. 12. 2021, Vendim nr. 830, me numër protokollit të datës 21. 12. 2021 ka kërkuar të shpallet konkurs i rregullt. Realisht vendimi i inspektoratit më shumë ka të bëjë me procedurat e përzgjedhjes të stafit mësimdhënës dhe për këtë ka kërkuar që të shpallet konkurs i rregullt. Edhe nga QKMF apo jashtë saj të vijnë kandidatët sipas procedurave të rregullta. DKA në Klinë sipas këtij vendimi të inspektoratit ka shpallur konkurs të rregullt me nr. 04-111- 2267/22 të datës 20. 01. 2022. Kjo është e tera e gjetur e inspektoratit që ne nuk mund të i kundërshtojmë dhe sigurisht që në afatet e nevojshme ligjore do ti përmirësojmë. Atë që po e thotë dr. Zafi, sigurisht që ne do të donim ti kishim edhe 6-të të punësuar në këtë drejtim por mendoj pa dashur që të prejudikoj, se në çdo konkurs të hapur nuk do të ketë kandidat mjekë. Mbetet të shihet. Pra, inspektorati ka gjetur si gabim vetëm konkursin publik, sepse unë besoj që mjekët që kanë punuar aty nga QKMF-ja kanë qenë mjekë të diplomuar që kanë dhënë mësim, ndërsa pjesën e ushtrimeve e kanë mbajtur infermierët e QKMF-së. Të gjeturën e inspektoratit tani e kemi përmirësuar me shpalljen e tre vendeve të lira. Sigurisht që në të ardhmen do të shpallim edhe konkurse të tjera për vende të punës në këtë dikaster por për momentin DKA ka pasur mundësi për të shpallur vetëm këto tre vende të lira pune. Jemi jetikisht të interesuar që në drejtimin e infermierisë të kemi kuadër profesional bazuar në udhëzimet administrative dhe ligjet në fuqi. Sa i përket konkursit që kishte të bënte me emrin konkret të përmendur, unë nuk mund të jap argumente të tjera përveç se të zgjidhen këto probleme për mes iniciativës ligjore të filluar nga familja Gashi. Nuk do të doja të kundërshtoja asgjë pasi që nuk jam pjesë e ngjarjes.

z. Zafer Gashi: Ne do të dalim me një propozim se si të dalim nga kjo. Fillimisht kryetar ju lutem mos u mundo që të i zbusësh gjerat sepse kur janë shumë të dukshme është problem. Nuk mbahet praktikë në institucion të shkollës së mesme të mjekësisë, praktika mbahet në QKMF. Këta persona me emër e mbiemër që inspektorati i ka evidentuar kanë dhënë dhe japin mësim në objektet e shkollës së mesme profesionale, prandaj nuk mund të riaktivizohet. Janë të gjetura të inspektoratit. Pyetja konkrete, kush i ka paguar këta persona? Me çfarë ligji i keni paguar? Nuk ju keni dhënë paga fare. Ata deklarojnë se kanë marrë paga nga QKMF-ja. Propozimi konkret është: Unë e ofroj vetën time që të jap mësim pa para, i gjej edhe tre profesionistë të tjerë që do të punojnë pa para, nëse lejohet me ligj.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Stafi i QKMF-së sipas memorandumit të firmosur është paguar për orët shtesë sipas ligjit, mirë po inspektorati ka kërkuar që të ketë procedurë të rregullt të zgjedhjes së stafit punues. Unë i inkurajoj të gjitha ata profesionistë që kanë mundësi që të kontribuojnë. Tani nuk do të ketë pagesë për orët shtesë por sipas ligjit që e rregullon këtë çështje: Pagë primare, pagë sekondare etj. Uroj që të kemi mjekë të cilët do të kyçen në sistemin arsimor me pagë primare. Ne jemi të interesuar që deri në fund të këtij semestri ta stabilizojmë gjendjen pasi që kemi marrë vërejtje serioze nga inspektorati. Besoj që më hapjen e tre vendeve të punës nga drejtoria e arsimit do të jetë një fillim i mbarë në zgjidhjen e këtij problemi.

Pika 15 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje

Kryesuesi i kuvendit theksoi se kishte një propozim në lidhje me pikën Pyetje dhe Përgjigje nga anëtari i kuvendit Valmir Bacaj dhe është mirë që ajo të bëhet praktikë në të ardhmen. Pra, pyetjet të bëhen me shkrim paraprakisht dhe përgjigjet të merren në seancë më të detajuara dhe kënaqshme.

z. Arben Limanaj: I kam dy shqetësime që dua të i ngrit tek drejtoria e arsimit. Nuk e diji se sa drejtori i ri e ka shfletuar udhëzimin administrativ për zgjedhjen e drejtorëve dhe ushtruesve të detyrës së drejtorëve nëpër institucione arsimore. Duhet parë aty se ushtrues detyre i drejtorit udhëzimi thotë se kandidati duhet të jetë mësimdhënës nga e njëjta shkollë. Vetëm nëse s` ka arsimtar që i plotëson kriteret nga ajo shkollë mund të vije nga një shkollë tjetër. Përveç kësaj sipas udhëzimit 151/20, ushtruesi i detyrës së drejtorit duhet të i plotësoj kriteret e njëjta siç janë për zgjedhjen e drejtorit. Ju propozoj që të i shikoni këto udhëzime dhe të bëni përmirësimet e duhura. Janë katër shkolla që ushtruesit e detyrës së drejtorit nuk i plotësojnë kriteret. Çështja e dytë është kalimi online i mësimdhënies në katër shkolla në qytet, nuk e diji a jeni këshilluar me këshillat e shkollave që të mbahet mësim me grupe. Për arsye se mësimi online nuk ka shumë efikasitet.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Shtabi Komunal i menaxhimit të emergjencës së pandemisë në konsultim me TASK forcat e shkollave në fjalë ka marrë vendim që këto katër shkolla të kalojnë online në procesin mësimor. Mendoj që është marrë një vendim i duhur bazuar në situatën e krijuar me covid kohëve të fundit.

z. Kushtrim Haliti: Përshëndetje. Kam një pyetje për kryetarin në lidhje me shujtat e mësimdhënësve të cilat ju janë premtuar që në vitin e kaluar. A do të dalin mjetet e këtyre shujtave këtë muaj apo kur do të dalin? Pyetja tjetër për drejtorin e arsimit: A mund të i pajisni shkollat me kontejnerë të mbeturinave sepse ka shumë shkolla që nuk kanë?

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Në lidhje me pagesën e shujtave për mësimdhënësit që është obligim nga marrëveshja kolektive, është një obligim që na është bartur neve komunave pa të drejtë prandaj të gjitha komunat e Kosovës janë të ngulfatur nga këto procese, por Komuna e Klinës falë edhe një vendimi që është marrë në Kuvendin e Komunës, por edhe sy çelhtësisë që ka pasur ekzekutivi, jemi një nga komunat në gjendjen më të mirë në këtë drejtim. Ne nuk i kemi paguar shujtat vetëm për një interval të vitit 2021, diku nga muaji mars deri në fund të vitit. Tani jemi dakorduar me sindikatën e arsimit dhe drejtorin e financave që të kryejmë pagesat bashkë me pagën e shkurtit. Për kontejnerët e munguar nëpër shkolla, mënoj që drejtori i DKA do ta ketë parasysh këtë por gjithsesi drejtorët e shkollave duhet që të kujdesën për pajisjen e shkollave me kontejnerë.

z. Armend Beqiri: Përshëndetje të gjithëve. Unë kam një propozim që zëvendësimi i mësimi që po bëhet të shtunave të shtyhet pasi që është vala e covidit dhe e gripit sezonal. Nuk e dijë përgjegjësi e kujt është, e ministrisë së arsimit apo e drejtorisë së arsimit kjo. Pra mësimet zëvendësuese të planifikuara që të mbahen të shtunave të këtij muaji të shtyhen për në muajin e ardhshëm.

z. Qemajl Sejdija, drejtor i DKA: Zëvendësimet e mësimëve të humbura janë të udhëzuara dhe caktuara nga ministria e arsimit. Vetëm në raste kur kemi shumë të infektuar është e mundur të bëjmë ndryshime.

z. Zafer Gashi: Dëshiroj që ta pyes kryetarin se a ka marr një kërkesë të dërguar nga z. Bekim Gashi, me datë 26. 04. 2021 lidhur me procedurat e dhënies së lejes një lokali për punë. Një lokal i marrë nga komuna dhe i dhënë me qira më pastaj.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Sa më kujtohet kërkesa është pranuar dhe drejtoria e shërbimeve publike është marrë me atë çështje dhe ju është dhënë përgjigja. Po ashtu mendoj që ky rast është objekt i hetuesisë.

Kryesuesi i kuvendit pasi që konstatoi se nuk ka të tjera pyetje nga anëtarët e kuvendit, duke i falënderuar për kontributin e dhënë e shpall të mbyllur mbledhjen e kuvendit.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi i Kuvendit:

Fadil Gashi